



Politika e CoxHealth për arkëtim

CoxHealth dëshiron t'ju ndihmojë të kuptoni procesin e faturimit dhe arkëtimit dhe burimet që janë në dispozicion për ju dhe familjen tuaj.

CoxHealth do të ofrojë kujdes pa diskriminim për rastet e emergjencës mjekësore pa marrë parasysh mundësinë e pacientit për të paguar. Nëse jeni i mbuluar nga sigurimi siç është Medicare, Medicaid, qeveria ose sigurim tjetër shëndetësor, CoxHealth do ta faturojë sigurimin pas trajtimit tuaj. Nëse jeni i siguruar dhe keni pyetje në lidhje me mbulimin tuaj ose nivelin tuaj të përfitimeve, ju lutemi kontaktoni ofruesin tuaj të sigurimit. Nëse nuk jeni i siguruar dhe plotësoni kushtet e caktuara për të ardhurat, ju mund të aplikoni për asistencë financiare duke përfshirë çmimet me zbritje të spitalit dhe planet për pagesa pa interes. Për më shumë informacione në lidhje me Politikën e Asistencës Financiare (FAP) të CoxHealth dhe mënyrën e aplikimit ose parashtrimin të kërkesës për të marrë njoftim me shkrim ose komunikim elektronik, flisni me një përfaqësues të shërbimit të pacientëve ose telefononi në numrin 417-269-0523. Informacioni dhe formularët e aplikimit janë gjithashtu në dispozicion në çdo spital të CoxHealth, në vendndodhjen e klinikës, ose në www.coxhealth.com.

Dita e shërbimit

Para ose në ditën e pranimit të shërbimit, do t'ju kërkohet të paguani pjesën tuaj të përgjegjësisë së vlerësuar për shërbimet. Nëse keni sigurim, përgjegjësia e vlerësuar do të përcaktohet në bazë të përfitimeve tuaja nga sigurimi. Nëse nuk jeni i siguruar nga ju do të kërkohet një shumë e të hollave si garanci. Nëse ju ofrohet kujdes në një departament të emergjencës së CoxHealth, pagesa nuk do t'ju kërkohet derisa të keni kryer kontrollin mjekësor.

Deklaratat e faturimit

Pas trajtimit tuaj, deklaratat e faturimit do t'ju dërgohen me postë për çfarëdo shume që ju mund të keni borxh. Bashkë me faturën tuaj ne do të dërgojmë informacion për mënyrën e aplikimit për asistencë financiare. Pagesa e plotë pritet brenda tridhjetë (30) ditëve nga deklarata. Nëse keni nevojë për ndihmë për të paguar faturën tuaj, dëshironi të bëni marrëveshje për pagesë ose të konsideroheni për asistencë financiare, është e rëndësishme që të na kontaktoni sa më parë në numrin e telefonit të shënuar në deklaratën e faturimit për të shmangur kreditimin e llogarisë tuaj nga një agjenci arkëtuese. Ju mund të aplikoni për asistencë financiare deri në dyqind e dyzet (240) ditë pas deklaratës fillestare të faturimit. Përveç deklaratave të faturimit, dikush mund t'ju telefonojë në lidhje me llogarinë tuaj.

Pyetjet për fatura, kundërshtimet ose kërkesa për faturë të detajuar

Ju lutemi na kontaktoni në numrin e telefonit të shënuar në deklaratën e faturimit nëse dëshironi të pyesni ose të kundërshtoni faturën tuaj. Deklarata e detajuar e pagesave për shërbimet e ofruara nga CoxHealth është në dispozicion nëse kërkohet.

Marrëveshjet për pagesë

Nëse nuk jeni në gjendje ta paguani plotësisht detyrimin tuaj, marrëveshjet për pagesë mund të bëhen duke na telefonuar në numrin e telefonit të shënuar në deklaratën e faturimit. Marrëveshjet për pagesë duhet të jenë të pranueshme nga CoxHealth në përputhje me direktivat e përkruara më poshtë për të shmangur kreditimin e llogarisë tuaj nga një agjenci arkëtuese. Nëse mendoni se nuk jeni në gjendje të paguani shumën e detyruar më poshtë, do të kërkohet një deklaratë e kompletuar financiare për t'u marrë në shqyrtim.

Direktivat për secilin spital të CoxHealth:

Limiti i detyrimit	Nr. i muajve për t'u paguar	Shuma e pagesës
\$49 e më pak	PLOTËSISHT	PLOTËSISHT
\$50-\$300	3 muaj	\$50-\$100
\$301-\$450	5 muaj	\$60-\$90
\$451-\$600	6 muaj	\$75-\$100
\$601-\$900	7 muaj	\$85-\$128
\$901-\$1500	8 muaj	\$112-\$187
\$1501-\$3000	12 muaj	\$125-\$250
\$3001-\$6000	15 muaj	\$200-\$400
\$6001-9,999	18 muaj	\$333 e më shumë
Mbi \$10,000	24 muaj	\$416 e më shumë

Direktiva për secilën klinikë (Ferrell-Duncan Clinic, CoxHealth Regional Services, CoxHealth Branson Clinics, CoxHealth Monett Clinics dhe Cox Barton County Clinics):

Limiti i detyrimit	Nr. i muajve për t'u paguar	Shuma e pagesës
\$49 e më pak	PLOTËSISHT	PLOTËSISHT
\$50-\$300	3 muaj	\$50-\$100
\$301-\$450	5 muaj	\$60-\$90
\$451-\$600	6 muaj	\$75-\$100
\$601-\$900	7 muaj	\$85-\$128
\$901-\$1500	8 muaj	\$112-\$187
Mbi \$1500	12 muaj	\$125 e më shumë

Agjencitë arkëtuese

CoxHealth përdor agjencitë arkëtuese për të ndihmuar në arkëtimin e detyrimeve të papaguara. Nëse një faturë është e papaguar për njëqind e njëzet (120) ditë ose më shumë dhe nuk është rregulluar sipas planit të përcaktuar për ekzekutimin e pagesave, CoxHealth mund t'i dërgojë llogarinë një agjencie arkëtuese për të mbledhur këto detyrime. Gjatë periudhës së arkëtimin, kërkesa për asistencë financiare do të pranohet në çdo kohë. Sapo të pranohet aplikimi, arkëtimi i detyrimeve do të shtyhet.

Nëse një faturë është akoma e papaguar pas dyqind e dyzet (120) ditëve, CoxHealth mund 1) ta raportojë atë te një subjekt për raportimin e kredive, 2) të nisë çështje civile kundër pacientit, ose 3) të vendosë një përqindje sigurimi mbi pronën e individit si garanci pagese. Para se të nisnin këto veprime, CoxHealth do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të përcaktuar nëse individit ka të drejtë për asistencë sipas FAP. Tridhjetë (30) ditë para fillimit të veprimit të arkëtimin, CoxHealth do të:

- i. Dërgojë një njoftim te pacienti i cili (a) tregon se asistencë financiare është në dispozicion për ata që kanë të drejtë dhe (b) identifikon veprimin që CoxHealth synon të ndërmarrë dhe datën pas të cilës CoxHealth do të ndërmarrë një veprim të tillë;
- ii. Ofrojë një kopje të përmbledhjes së thjeshtë gjuhësore të FAP dhe informacion se si të merrni një kopje të aplikimit për FAP; dhe
- iii. Përpiqet ta kontaktojë pacientin dhe ta njoftojë atë me gojë për borxhin e papaguar dhe ekzistencën e FAP.

Ju lutemi që të jeni i vetëdijshëm se mund të ndërmerren veprime ligjore për çdo detyrim të papaguar ose kombinim të detyrimeve të papaguara që arrijnë shumën prej dy mijë e pesëqind ose më shumë. CoxHealth nuk do të ndërmarrë veprime ligjore për mospagimin e çfarëdo shume të zbritur si rezultat i kërkesës së aprovuar për asistencë financiare, për aq sa zbritja e tillë është aplikuar në mënyrë të saktë dhe të përshtatshme për një individ të kualifikuar sipas FAP. Megjithatë, detyrimet që mbeten pas zbritjeve të tilla do të jenë objekt i aktivitetit të arkëtimin, duke përfshirë edhe veprimin ligjor.

Para raportimit të detyrimit të papaguar te zyrat kreditore, fillimit të një veprimi civil ose vendosjes së një përqindjeje sigurimi mbi pronën e individit si garanci pagese, do të bëhen përpjekje të arsyeshme për të njoftuar individin për politikën e asistencës financiare.

CoxHealth nuk do të kërkojë pagesë të interesit për detyrimin e mbetur pas aplikimit të zbritjes së asistencës financiare. Sidoqoftë, CoxHealth mundet, sipas gjykimit të vet, të kërkojë pagesë të interesit ndaj detyrimit nëse 1) Garantuesi nuk e kryen pagesën sipas marrëveshjes për pagesë, ose 2) detyrimi është referuar për arkëtim.

Asistencë financiare

Ju lutemi mos ngurroni të pyesni për asistencën financiare. Ne jemi këtu për të ndihmuar.